



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2024

Lënda: Kthim përgjigje

Ne përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Rrjeti ujor i Lumit Drin formohet nga dy burimet e tij Drini i Zi dhe Drini i Bardhë. Drini i Zi buron nga Liqeni i Ohrit dhe rrjedh në veri duke kaluar kufirin ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë. Ndërsa Drini i Bardhë rrjedh nga Kosova. Të dy këto lumenj bashkohen në rezervuarin e Fierzës dhe nga aty, Drini kalon kaskadën e digave të katër rezervuarëve dhe hidrocentraleve si ai i Fierzës, i Komanit, i Vau Dejësit dhe i Spatharit.

Rrjedha e poshtme/fundore e Drinit është pjesë e territorit të Bashkisë Shkodër. Në këtë nivel, Drini bashkohet edhe me prurjet ujore të lumit Kir në verilindje të qytetit të Shkodrës.

Ky përshkrim na orjenton edhe në dhenien e përgjigjeve për kërkesën tuaj.

1. Në rrjedhën e poshtme fundore të Drinit, pjesë e Bashkisë Shkodër, nuk ka vend - depozitime të paligjshme mbeturinash. Bashkia Shkodër ka pasur një vend-depozitim mbetjesh (ish fusha e mbetjeve) e cila ka qenë në afërsi të lumit Kir (pra jo në rrjedhën e lumit Drin). Ky vend depozitimësh është i mbyllur dhe nuk funksionon si i tillë, menjëherë me venien në funksionim të landfillit të Bushatit. (rreth 15 vite më parë).
2. Për rehabilitimin e kësaj fushe Bashkia Shkodër ka një plan rehabilitimi por kosto e tij kalon mundësitë financiare të bashkisë.
3. Ndergjegjesimi i komunitetit për çështjet mjedisore dhe jo vetëm është pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të bashkisë, por Strategji për ndergjegjesimin për mbrojtjen e lumenjve nuk ka.

Ligji nr Ligji nr 111/2012 "per Menaxhimin e integruar te burimeve ujore"i ndryshuar (pjese e tyre edhe lumi Drin) , percakton qarte se

Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore: b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

Organet qendrore për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore janë: a) Këshilli i Ministrave; b) Këshillit Kombëtar i Ujit; c) Ministria; ç) Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit. 2. **Organet vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë:** a) këshillat e baseneve ujore; b) agjencitë e baseneve ujore.

Pra sic shihet kompetencat e NJVQV ne kete fushe jane te kufizuara.

4. Trajtimi i ujrave te zeza ne fshatrat/zonat urbane prane lumit dhe jo vetem eshte detyre funksionale e SHARajonale Ujesjelles kanalizime Shkoder.

Faleminderit